Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij moduli studenti do të jetë në gjendje <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ti dalloj grupet kryesore të ushqimeve dhe përzierjet e ushqimeve të cilat përdoren në të ushqyerit e kategorive të caktuara të kafshëve.</li> <li>- Ai do të fitoj njohuritë bazë teorike për mënyrat e përgatitjes, konservimit dhe ruajtjes së ushqimeve për kafshë.</li> <li>- Ai do të jetë në gjendje të aplikoj në praktikë këto njohuri.</li> </ul>

	- Ai poashtu do të fitoj njohuritë bazë për teknikat kryesore të formulimit të përzierjeve të koncentruara për kategoritë e caktuara të kafshëve.		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë
Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	1	4	4
Konsultime me mësimdhënësin	2	2	4
Puna në terren	5	1	5
Testi, punimi seminarik	1	3	3
Detyrë shtëpie	2	3	6
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	2	1	2
Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata teorike, ushtrime laboratorike, punë praktike në fermë dhe teren, seminare, diskutim, punë në grupe. Përdorimi i mjeteve bashkëkohore audiovizuale për ligjërata dhe konkretizim të mësimin		
Metodat e vlerësimit:	<p>Studenti duhet të ketë marrë një notë 6 apo më shumë nga vlerësimet gjatë mësimin ose për punën e tij në ushtrimet laboratorike dhe nga shkruarja dhe prezantimi i seminarëve (nëse kjo është kërkuar).</p> <p>Provimi Përfundimtar përbëhet nga tri pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pjesë kualifikuese e provimit është njohja e ushqimeve dhe përkatësia e tyre në grupe. Ky është një parakusht për t'iu nënshtruar provimit me shkrim.</li> <li>1. Pjesa e dytë e provimit është provimi me shkrim. Studenti duhet të mbledhë më shumë se 50% të pikëve në pjesën me shkrim në mënyrë që ti nënshtrohen provimit përfundimtar.</li> <li>2. Provimi përfundimtar mund të jetë me shkrim, dhe/ose me gojë. Nga studenti gjithashtu mund të kërkohe arsyetimi me gojë për punën e bërë në provimin përfundimtar nëse është kryer me shkrim.</li> </ol> <p>Pjesë e notës përfundimtare është edhe pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjërata (10% e notës) si dhe përgatitja me shkrim dhe/ose prezantimi me gojë i seminarit (deri 20% e notës).</p>		
Literatura primare:	Materialet e prezantuara në Ligjërata dhe ushtrime		
Literatura shtesë:	(kapituj të zgjedhur).		
	R.O. Celems and D.C. Church, 2002. Livestock feeds and Feeding.		
	M. H. Jurgens, 1997. Animal Feeding and Nutrition (Seksionet I, II dhe III).		

	Pesti, G.M., R.I. Bakalli, J.P. Driver, A. Atencio, E.H. Foster, 2005. Poultry Nutrition and Nutrition. Trafford Publishing. ISBN 1-4120-7536-x.
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1	Hyrje. Lënda e studimit, lidhja me shkencat tjera, ndarja e lëndës.
Java 2	Ushqimet, kuptimi dhe definicioni, roli ekonomik, ndarja e ushqimeve.
Java 3	Ushqimet me prejardhje bimore dhe metodat e konservimit të tyre: a) Ushqimet voluminoze, ushqimet e gjelbra nga livadhet, leguminozet dhe drithërat si ushqime voluminoze, ushqimet rrënjore dhe ushqimet tjera voluminoze.
Java 4	Ushqimet me prejardhje bimore dhe metodat e konservimit të tyre-vazhdim; b. Metodatat e konservimit të ushqimeve voluminoze: Tharja dhe dehidrimi, procesi teknologjik. Roli dhe rëndësia e sanës. Konvejeri i gjelbër.
Java 5	Silazhimi, teknikat e silazhimit. Parakushtet për silazhim.
Java 6	Vlerësimi i cilësisë së silazhit, vlera ushqyese dhe mundësitë e përdorimit të silazhit. Planifikimi i kërkesave për silazh,
Java 7	Vlerësimi i parë (1 orë)
Java 8	Ushqimet e koncentruara. Drithërat dhe leguminozet..
Java 9	Prodhimet dytësore të industrisë së përpunimit miellit dhe vajit Produktet e industrisë së sheqerit, alkoolit, birrës dhe amidonit.
Java 10	Ushqimet me prejardhje animale: Përbërja, vlera ushqyese dhe roli i ushqimeve me prejardhje shtazore në të ushqyerit e kafshëve. Qumështi dhe prodhimet nga qumështi, Mielli i peshkut dhe i mishit, mielli i eshtrave dhe i mishit, mielli i gjakut, mielli i puplave, mielli i organeve të brendshme.
Java 11	Ushqimet me prejardhje minerale dhe shtojcat në ushqim: Rëndësia dhe mundësia e përdorimit. Kripa e kuzhinës, mielli i eshtrave, shkumësi i kafshëve, premikset, vitaminat antibiotikët, yndyra, urea, etj.
Java 12	Përzjerjet e koncentruara. Principet e prodhimit. Llojet e përzjerjeve për kategoritë e ndryshme të kafshëve.
Java 13	Principet e përpilimit të racioneve. Metodatat për balancimi i lëndëve ushqyese në racion (Algjebrike, katërkëndëshi i Pirsonit),
Java 14	Optimalizimi i përpilimit të racioneve. Programet kompjuterike për përpilimin e racioneve, WUFFDA
Java 15	Kërkesat e reja për cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve për kafshë. Legjislacioni i Kosovës dhe BE për ushqimet për kafshë.
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<p>Studentët janë të obliguar të përcjellin rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet. Me më shumë se tri mungesa të paarsyetuara në ushtrime studentit nuk do ti vërtetohet vijimi i rregullt. Gjatë orëve të ligjëratave, ushtrimeve laboratorike dhe praktike si dhe punëve në teren, studentët janë të obliguar të respektojnë rregullat e përgjithshme të mirësjelljes akademike (hyrja me kohë në mësim, mbajtja e qetësisë, ç'kyçja e telefonave mobil).</p> <p>Vërejtje: Për shkak të pranisë së lëndëve të rrezikshme në laborator, kërkohet respektimi i masave të sigurisë (përdorimi i veshmbathjes përkatëse).</p>	

## Titulli i lëndës: AGRONOMI DHE ZOOTEKNI E KAFSHËVE NË BUJQËSINË

### ORGANIKE

<b>Informatat themelore për lëndën</b>			
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë		
Titulli i lëndës:	Agronomi dhe Zootekni e Kafshëve në bujqësinë organike		
Niveli:	Bsc		
Statusi i lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Kreditë ECTS:	6 ECTS		
Koha / Vendi:	Klasa ...   Sipas orarit		
Mësimdhënësi:	Nuridin Mestani		
Të dhënat kontaktuese:	nuridin.mestani@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Agronomi dhe Zootekni e Kafshëve në bujqësinë organike” përfshinë njohjen me ekologjinë dhe pjellorinë e tokës, të ushqyerit e bimëve dhe metodat e avancuara për përmirësimin e të ushqyerit të bimëve, kriteret për zgjedhjen e varieteteve në bazë të aftësisë mbirëse dhe cilësisë së saj, menaxhimin e kullosave në bujqësinë ekologjike, kultivimin e perimeve ekologjike, ndërlidhjen funksionale në mes mbarështimit të kafshëve dhe ambientit, ndërlidhjen specifike në mes llojeve të veçanta të kafshëve dhe ambientit, etj.		
Qëllimet e lëndës:	Duke u bazuar në njohuritë bazë të prodhimit bimor dhe prodhimit blegtoral, që janë trajtuar në kursin bazik, studentët mund ti përshkruajnë karakteristikat e prodhimtarisë bimore dhe prodhimtarisë blegtorale në bujqësinë ekologjike dhe ti tregojnë sfidat e tyre.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"><li>- Fitoj njohuri për elementet bazike të ekologjisë dhe pjellorisë së tokës.</li><li>- Fitoj njohuri për masat preventive dhe kurative për mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve.</li><li>- Mëson kriteret për zgjedhjen e varieteteve dhe farës cilësore.</li><li>- Duke e ndërlidhë pjesën teorike me atë praktike dhe vizitat në ferma, studenti do të aftësohet për të menaxhuar teknologjinë e mbarështimit të kafshëve dhe ndërlidhjen e tyre me ambientin.</li></ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë

Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	2	4	8
Konsultime me mësime të ndërhënësin	2	3	6
Puna në terren	8	2	16
Testi, punimi seminarik	2	3	6
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	2	10	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	1	3	3
Total			150
Metodat e mësime të ndërhënësin:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjëratat (prezantimi me Power Point, foto, grafikone)</li> <li>- Puna praktike (pune laboratorike, Vizitat në ferma)</li> <li>- Puna individuale/prezantim nga studentet</li> <li>- Puna në grupe</li> <li>- Vlerësimi i përgjithshëm (vijueshmëria)</li> </ul>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë: 20%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 20%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 10%</p> <p>Vijimi i rregullt: 10%</p> <p>Provimi final: 40%</p> <p>Total 100%</p>		
Literatura primare:	<p>Neuerburg, W., S.Padel: Organisch-biologischer Landbau in der Praxis, Verlagsunion Agrar, Munchen.</p> <p>Gliessman, S. R., Krieger, R., E. Engels. 1997. Agro ecology: Ecological processes in sustainable agriculture. Amazon, CRC Press, London.</p>		
Literatura shtesë:	<p>Mestani, N: Shpendaria. Ligjëratat të autorizuara, Prishtinë, 2012.</p> <p>Sena L. dhe G.Stefi: Rritja e shpendëve. Universiteti bujqësor i Tiranës, Tiranë, 2009.</p> <p>Bakalli R. dhe N.Mestani: Të ushqyerit e jopërtypësve. Fakulteti i bujqësisë, Prishtinë, 1996.</p> <p>Bakalli, R. dhe Xh.Domi: Shpendaria. Biblioteka libri bujqësor, Prishtinë, 1985.</p>		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratës		
Java 1	Ekologjia e tokës, pjelloria e tokës		
Java 2	Ciklet dhe ballancet ushqyese, si dhe mënyrat për të përmirësuar të ushqyerit e bimëve		
Java 3	Masat preventive dhe kurative për mbrojtjen e bimëve, sidomos në pemëtari		
Java 4	Synimi i punimit adekuat dhe aktivitetet për kultivimin e bimëve		
Java 5	Testi i parë intermediar		

Java 6	Kriteret e përzgjedhjes së tipit dhe përzgjedhjes së varieteteve, qarkullimi i kulturave, mbirja dhe fuqia mbirëse e farës së mbjellë, trajtimi i farës dhe cilësia e saj.
Java 7	Menaxhimi i kullosave në bujqësinë ekologjike
Java 8	Kultivimi i perimeve ekologjike
Java 9	Ndërlidhja energjetike dhe funksionale në mes të mbarështimit të kafshëve dhe ambientit
Java 10	Testi i dytë intermediar
Java 11	Aplikimi i teknologjive të ndryshme në mbarështimin e kafshëve dhe ndërlidhja me ambientin
Java 12	Ndërlidhja specifike e llojeve të ndryshme të kafshëve me ambientin
Java 13	Mbarështimi i ripërtpësve dhe jo ripërtpësve
Java 14	Vizitë fermave.
Java 15	Testi Final.
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
Pjesëmarrja e studentëve në ligjërata, ushtrime dhe punë praktike në terren është e obligueshme. Është i dëshirueshëm organizimi i studentëve në punë grupore.	

### Titulli i lëndës: BAZAT SOCIO- EKONOMIKE NË BUJQËSINË ORGANIKE

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Bazat socio-ekonomike në Bujqësinë Organike
Niveli:	Bsc
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa ...   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Arben Mehmeti
Të dhënat kontaktuese:	arben.mehmeti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda trajton çështjet themelore të Bujqësisë organike dhe aspektet socio-ekonomike. Gjatë mësimit studentët do të informohen për kuptimin e bujqësisë organike, vështrimin historik të bujqësisë organike. Përhapja e bujqësisë organike në Botë, dhe Evropë. Projekte kërkimore në drejtim të bujqësisë organike. Organizatat ndërkombëtare për bujqësi organike. Gjatë mësimit studentët duhet të ndërjegjësohen për prodhimtarinë organike të drithërave, perimeve, pemëve, vreshtave dhe bimëve mjekësore dhe aromatike si dhe menaxhimi i prodhimtarisë organike në blegtori.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është që studentët të njoftohen me

	<p>bazat themelore të Bujqësisë organike dhe aspektet socio-ekonomike. Rëndësia e bujqësisë organike në ekosistemet natyrore dhe problemet të lidhura me aktivitetet bujqësore dhe rëndësia e biodiversitetit. Aspektet socio-ekonomike të bujqësisë organike, shfrytëzimin e resurseve natyrore si dhe zgjidhje nga një perspektivë socio-ekonomike përmes bujqësisë organike. Agroteknika në prodhimtarinë organike të drithërave, perimeve, pemëve, vreshtave dhe bimëve mjekësore dhe aromatike si dhe menaxhimi i prodhimtarisë organike në blegtori. Zgjedhja e llojeve dhe e kultivarve në prodhimtarinë integrale dhe organike të pemëve. Legjislacioni kryesor vendor dhe ndërkombëtar për bujtësin organike.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptojë rolin, funksionin dhe parimet e bujqësisë organike dhe rëndësinë e saj.</li> <li>- Të njohin dhe të gjykojnë marrëdhëniet socio-ekonomike në bujqësinë organike.</li> <li>- Të dinë për rregulloret kombëtare dhe Evropiane të bujqësisë organike.</li> </ul>

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë
Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	4	8	32
Konsultime me mësimdhënësin	1	4	4
Puna në terren	8	2	16
Testi, punimi seminarik	2	3	6
Detyrë shtëpie	2	4	8
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	6	12
Përgatitja për provimin final	2	2	4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Total			150

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësiminës është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me gojë.
Metodat e vlerësimit:	Studentët duhet të jetë i aftë për punë ekipore, për zhvillimin e mendimit kritike dhe kreative si dhe për prezantimin e njohurive të fituara në kuadër të lëndës. Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së

	<p>secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv.  Vlerësimi i parë: 30 %  Vlerësimi i dytë: 25%  Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%  Vijimi i rregullt 5%  Provimi final 30%  Totali 100%</p>
Literatura primare:	Demaj, A. (2005): Prodhimtaria organike. Ligjerata të autorizuara. Fakulteti i Bujqësisë Prishtinë (skripta).
Literatura shtesë:	<p>Pequli, V, dhe Mankolli, H.(2005): Ekologjia e Zbatuar, UBT-Dita 2000.Tiranë 2005.</p> <p>Hansen, A. L. (2010): The Organic Farming. Manula. A Comprehensive Guide to Starting and Running a Certified Organic Farm. Storey Pub.</p>
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjërates
Java 1	Kuptimi i bujqësisë organike dhe vështrim historik i bujqësisë organike.
Java 2	Aspektet ekologjike të sistemeve bujqësore
Java 3	Koncepti, funksionet dhe bazat e bujqësisë organike
Java 4	Bujqësia organike dhe biodiversiteti
Java 5	Bujqësia organike në Kosovë dhe resurset prodhuese aktuale
Java 6	Përparësitë e bujqësisë organike
Java 7	Vlerësimi i parë
Java 8	Menaxhimi i prodhimitarisë organike lavërtarë
Java 9	Menaxhimi i prodhimitarisë organike perimore
Java 10	Bimët shëruese, aromatike dhe frutat pyjore në sistemet e prodhimitarisë organike
Java 11	Menaxhimi i prodhimitarisë organike në pemëtari dhe vreshtari
Java 12	menaxhimi i prodhimitarisë organike në blegtori
Java 13	Menaxhimi i teknikës bujqësore në prodhimitarinë organike
Java 14	Legjislacioni për bujqësi organike dhe normat teknike për zbatimin e saj
Java 15	Vlerësimi i dytë
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime</li> <li>- rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim</li> <li>- hyrja në sallë me kohë,</li> <li>- shkyçja e telefonave celular</li> </ul>	

**Titulli i lëndës: BIOLOGJIA DHE DËMET E SHKAKTUARA NGA PATOGJENËT,  
BARËRAT E KËQIJA, DËMTUESIT**

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Biologjia dhe dëmet e shkaktuara nga patogjenët, barërat e këqija, dëmtuesit
Niveli:	Bsc
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa ...   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Arben Mehmeti
Të dhënat kontaktuese:	arben.mehmeti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda trajton çështjet themelore të biologjisë dhe përhapjes së patogjeneve, barërave të këqija dhe dëmtuesve. Gjithashtu shpjegohen edhe dëmet nga këta agjent të dëmshëm biologjike si dhe pragun kritik ekonomike për përdorim të pesticideve. Masat mbrojtëse për kontrollin e agjenteve të dëmshëm biologjike. Përdorimi i pesticideve në bujqësi sinteza, formulimi, qarkullimi, deponimi, përdorimi në fushë dhe në lokale të mbyllura si dhe pasojat sporadike që mund të arrijnë me përdorimin e tyre. Aspektet ekologjike të përdorimit të pesticideve respektivisht ndikimi i pesticideve në mjedis.
Qëllimet e lëndës:	Që studentët nëpërmes kësaj lënde të fitojnë njohuri për rëndësinë e përdorimit të pesticideve në bujqësi dhe njohjen e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqija në kulturat kryesore bujqësore. Ligjshmërinë e manipulimit me pesticide si materie të rrezikshme për ambientin. Për sintezën, formulimin, qarkullimin, deponimin, përdorimin në fushë dhe në lokale të mbyllura si dhe pasojat sporadike që mund të arrijnë me përdorimin e tyre. Gjithashtu duhet të fitojnë njohuri për ndikimin e pesticideve në mjedis. Studenti duhet të jetë i aftë për punë ekipore, për zhvillimin e mendimit kritike dhe kreative si dhe për prezantimin e njohurive të fituara në kuadër të lëndës.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të fitojnë njohuri për sëmundjet, dëmtuesit dhe barërat të këqija në kulturat kryesore bujqësore</li> <li>2. Të fitojnë njohuri më të gjerë për pesticidet dhe ndikimin e tyre në mjedis.</li> <li>3. Të dije t'i zbatoj ligjet dhe rregulloret për manipulimin me pesticide.</li> <li>4. Të vetëdijesohen për kujdesin me pesticide dhe përdorimin e tyre.</li> </ol>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë
Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	4	8	32
Konsultime me mësimdhënësin	1	4	4
Puna në terren	8	2	16
Testi, punimi seminarik	2	3	6
Detyrë shtëpie	2	4	8
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	6	12
Përgatitja për provimin final	2	2	4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimit është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me gojë.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Studentet duhet të jetë i aftë për punë ekipore, për zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ si dhe për prezantimin e njohurive të fituara në kuadër të lëndës.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv.</p> <p>Vlerësimi i parë: 30 %</p> <p>Vlerësimi i dytë: 25%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%</p> <p>Vijimi i rregullt 5%</p> <p>Provimi final 30%</p> <p>Totali 100%</p>		
Literatura primare:	<p>Adem Demaj: Mbrojtja e ambientit të njeriut. Ligjërata të autorizuara. Fakulteti i Bujqësisë Prishtinë 2003 (skript).</p> <p>Susuri L. 1998. Fungicidet herbicidet. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë.</p> <p>Kaci A. 2003. Manuelet e Fitofarmacisë. Tiranë.</p> <p>Dervish Rozhaja dhe M. Jablanoviq : Ndotja dhe mbrojtja e ambientit</p>		
Literatura shtesë:	Maceljski, M.B. Cvetkovic, J. I.Baric, Z. Ostojic. 1997. Prirucnik iz zastite bilja. Zagreb. <a href="http://www.ergraf.hr.tiskara-md">http://www.ergraf.hr.tiskara-md</a> . □		
Hartimi i planit mësimor			

Java	Titulli i ligjëratisë
Java 1	Hyrje, Nocioni i mbrojtjes së bimëve
Java 2	Agjentet e dëmshëm (kërpudhat, dëmtuesit, barërat e këqija)
Java 3	Elementet e mbrojtjes së bimëve (Diagnoza, Prognozomi, Terapia)
Java 4	Pesticidet, Ndarja e pesticideve.
Java 5	Menaxhim i sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqija në kulturat lavëtarë
Java 6	Menaxhim i sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqija në kulturat perimore
Java 7	Menaxhim i sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqija në pemëtari-vreshtari
Java 8	Vlerësimi i parë
Java 9	Praktikat e mira menaxhuese për të reduktuar ndotjen (standardet për prodhimtarin bujqësor)
Java 10	Metodat e mbrojtjes së bimëve
Java 11	Mbrojtja e integruar dhe biologjike
Java 12	Roli i menaxhimit të pesticideve në ndikimin në mjedis
Java 13	Mbetjet e pesticideve në ushqim dhe mjedis.
Java 14	Marketingu i pesticideve në Kosovë, Legjislacioni- Ligji mbi pesticidet dhe rregulloret përkatëse
Java 15	Vlerësimi i dytë
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- vijim i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime</li> <li>- rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim</li> <li>- hyrja në sallë me kohë,</li> <li>- shkyçja e telefonave celular</li> </ul>	

## Titulli i lëndës: SHKENCAT KOMPJUTERIKE NË BUJQËSI

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Shkencat Kompjuterike në Bujqësi
Niveli:	Bsc
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa ...   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Bashkim Baxhaku
Të dhënat kontaktuese:	bashkim.baxhaku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Studenti aftësohet për përdorimin e kompjuterit personal. Ai aftësohet për shkrimin e raporteve me editorët e tekstit (MS Word – Microsoft Office ), si dhe krijimin e tabelave, llogaritjet tabelore dhe prezantimin e rezultateve në formë të grafikeve.

Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të aftësoj studentet në njohjen me lëmine e informatikës.</li> <li>- Të aftësohet te njehe pjesët e kompjuterit personale.</li> <li>- Të aftësohet për aplikimin e programeve Windows – programit operativ të kompjuterit personal.</li> <li>- Të aftësohet për pune me tekst procesorët për shkrimin e një raporti, teksti.</li> <li>- Të aftësohet për krijimin e tabelave të ndryshme në Excel dhe në Word, si dhe të aplikojë llogaritjet tabelore dhe prezantimin e rezultateve tabelore me metodat grafike.</li> </ul>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përdor kompjuterin personal për punët e veta.</li> <li>- Shkrimi i raporteve të ndryshëm ku përfshihen insertimi i fotografive, i formulave si dhe objekteve tjetër në dokumentin e punuar në Word.</li> <li>- Krijimi i tabelave të ndryshme, llogaritjet tabelore me të dhënat e faqeve të librit punues në Excel si dhe prezantimi i rezultateve tabelore në formë të grafikeve të ndryshëm</li> </ul>

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë
Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	2	6	12
Konsultime me mësimdhënësin	1	14	14
Puna në terren			0
Testi, punimi seminarik	2	3	6
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	5	2	10
Përgatitja për provimin final	10	2	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	4	3	12
Projektet, prezantimet, etj.	2	3	6
Total			150

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata klasike ku studenteve ju prezantohen materia e lëndës; seminarët nga një pjesë e lëndës që studenti e zgjedh për me e përpunuar; pas çdo ligjëratë hapet diskutimi për materien e përpunuar në ligjëratë ku studenti mund të kyçet me konstatimet e veta, sugjerimet ose pyetjet për lëmin që është përpunuar atë orë.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë – 20% Vlerësimi i dytë – 20% Vlerësimi i tretë – 20% Projekti dhe angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt – 10% Provimi final – 20% Total 100%
Literatura primare:	Bashkim Baxhaku – Bazat e informatikës (Pajisjet, Sistemi operativ,

	Word-i dhe Excel-i)
Literatura shtesë:	PC Hardware in a Nutshell, 3rd Edition by Robert Bruce Thompson and Barbara Fritchman Thompson (Paperback - Jul 30, 2003) – Illustrated  Windows XP Annoyances for Geeks, 2nd Edition by David A. Karp  Windows XP in a Nutshell, Second Edition by David A. Karp  Word 2007 Bible by David Angell, Peter Kent, and Brent Heslop
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1	Pajisjet – njësit hyrëse dhe dalëse; pllaka amë; tastiera; Pajisjet – tastiera; miu; njësia qendrore – mikroprocesori; Memoria operative RAM; Memoria vetëm për lexim – ROM; kesh memoria; Njësit dalëse: kartela grafike dhe monitori.
Java 2	Pajisjet – Njësit dalëse: printeri (shtypësi); Njësit hyrëse – dalëse: Disku, CD, DVD, kartela e zërit, kartela e rrjetit, pajisjet për prezantim
Java 3	Softueri, sistemi operativ; Softueri aplikativ; Freeware dhe Shareware e Open Source dhe Free Software; Paraqitja në sistem; Desktopi; Dritaret; Menytë; Dialogët; Ndihma; Dalja nga Windows-i; Startimi dhe mbyllja e aplikacioneve.
Java 4	Puna me më shumë aplikacione ose dritare njëkohësisht; Operacionet themelore me fajlla dhe folderë; Krijimi i fajllave dhe folderëve; Zgjedhja e fajllave dhe folderëve Menyja File; Menyja Edit; Menyja View; Menyja Favorites; Menyja Tools.
Java 5	Lëshimi i Word-it në punë; Dritarja kryesore e Word-it; Menyja kryesore; Puna me menytë e Word-it; Pullat kryesore; Pullat për paraqitje ne ekran; Shiritat me vegla.
Java 6	Shkrimi i tekstit; Lëvizja nëpër tekst; Ruajtja e tekstit; Emrat e fajllave; Ruajtja e fajlit në folderin aktual; Ruajtja në folder tjetër; Ruajtja e fajlit ekzistues ne disk; Hapja e fajlit.
Java 7	Hapja e fajlit ekzistues; Dalja nga Word-i; Gjetja dhe
Java 8	korrigjimi i tekstit; Zgjedhja e tekstit; Kopjimi, zhvendosja dhe fshirja e tekstit; Tipi dhe madhësia e shkronjave; Zgjedhja e njëkohshme e parametrave të tekstit.
Java 9	Hapja e Excel-it; Pamja e ekranit në Excel; Mënyra të tjera të hapjes së Excel-it; Shkrimi ne hapësirën punuese; Dritarja kryesore e Excel-it; Menyja kryesore; Pullat kryesore; Pullat qe lidhen me dokumentin e hapur.
Java 10	Shiritat me vegla; Shiriti standard; Shiriti për formatizim; Shirita të tjerë; Zhvendosja e shiritave; Ruajtja e librit punues; Emrat e fajllave; Ruajtja e fajlit ne folderin aktual; Ruajtja e fajlit ne folderin tjetër; Ruajtja e fajlit ekzistues ne disk; Ruajtja e librit punues përmes tastierës.
Java 11	Mbyllja e librit punues; Mbyllja e Excel-it; Hapja e librit punues; Hapja e librit punues te ri; Hapja e librit punues ekzistues; Selektimi i qelive; Pamja e të dhënave; Rregullimi i madhësisë se qelive; Rregullimi manual; Rregullimi automatik; Rregullimi përmes opsionit Format; Lartësia e rreshtave; Gjerësia e kolonave.
Java 12	Lëvizja në fletën punuese; Lëvizja përmes tastierës; Lëvizja përmes miut; Pozicionimi në qelinë e caktuar; Rregullimi i të dhënave në qeli; Rrafshimi, centrimi dhe dhëmbëzimi; Lloji dhe madhësia e shkronjave; Fonti; Madhësia e shkronjave; Stili i fontit; Zgjedhja e njëkohshme e parametrave të fontit; Përcaktimi i parametrave për

	ma shumë qeli.
Java 13	Shkrimi me ngjyra të ndryshme; Shkrimi vertikal; Shkrimi i teksteve të gjata; Editimi i të dhënave; Gjetja dhe zëvendësimi; Kopjimi; Zhvendosja; Fshirja e të dhënave.
Java 14	Insertimi i qelive, i rreshtave dhe i kolonave; Insertimi i rreshtave; Insertimi i kolonave; Fshirja e qelive, e rreshtave dhe e kolonave; Fshirja e qelive; Fshirja e rreshtave; Fshirja e kolonave; Bashkimi i qelive.
Java 15	Diagramet; Aktivizimi i sistemit grafik; Hapat që ndiqen gjatë vizatimit; Rregullimi i diagramit; Tipa të tjerë të diagrameve.
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
Studenti është i obligueshëm për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrime (mbahet evidenca), duhet të mbaje qetësinë gjatë mësimit, hyrja para arsimtarit – pas arsimtarit nuk lejohet hyrja në sallën e mësimit.	

### Titulli i lëndës: PROJEKTI DHE PUNA ARSIMOR

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	<b>Projekti dhe Puna Arsimore</b>
Niveli:	Bsc
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa ...   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Mujë GJonbalaj
Të dhënat kontaktuese:	muje.gjonbalaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lenda projekti dhe puna arsimore është e orientuar për të rritur shkathtesitë dhe njohuritë e studenteve për aftësitë praktike të menaxhimit të projektit nga pikpamjet e mësimdhënies . Lëndë projekti dhe puna arsimore ofron njohuri dhe aftësi për të zhvilluar një plan të menaxhimit të projektit për një investim që do të jetë bazë për zhvillimin e një sipërmarrësie të re.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës Menaxhi i projekteve është që t'i pajisë studentët me njohuri për (a) të parashikuar ndikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në mjedisin e biznesit dhe menaxhimin e vendimeve sipërmarrëse; (b) të interpretuar parametrat e tregut dhe mundësitë e reja të sipërmarrësisë; (c) të zhvilluar dhe analizuar buxhetin; (d) të identifikuar dhe përshtatur politikave qeveritare dhe

	formave ligjore të investimeve dhe sipërmarrësisë; (e) të vlerësojnë fizibilitetin e tregut dhe financiar të realizueshmerisë së produktit/shërbimit në sipërmarrësinë e tyre; (f) të zhvilluar aftësitë e komunikimit me partnerët dhe vlerësuar nevojën për menaxhimin e projekteve.			
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje për të vlerësuar gatishmërinë e tyre për t'u bërë sipërmarrës, të zbatojë një ide të biznesit dhe për të menaxhuar një ndërmarrje të re.			
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)				
	Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë
	Ligjëratat	2	15	30
	Ushtrime			
	Përgatitje për test intermediar	2	15	30
	Konsultime me mësimdhënësin	2	3	6
	Puna në terren	-	-	-
	Testi, punimi seminarik	1	3	3
	Detyrë shtëpie	2	3	6
	Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
	Përgatitja për provimin final	1	15	15
	Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	6	18
	Projektet, prezantimet, etj.	2	6	12
	Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies bazohet në: Ligjëratat, pune praktike, raste studimore, prezantime individuale dhe grupore për të sjellë gjetjet nga hulumtimi konkrete në fushën e Menaxhimit të Projektit. Do të ketë dy teste me shkrim praktikë gjatë ligjëratave dhe një provë përfundimtare. Çdo studenti pritët të përgatisë një ide të biznesit projektit.			
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve është i bazuar në ndjekjen e ligjëratave dhe pjesëmarrjen e tyre në leksione teorike dhe praktike, sukcesi në mes të testit përfundimtar dhe projektin përfundimtar të projektit (plani i biznesit). Kriteret për kalimin kursin bazohen në kriteret e vendosur në Bujqësisë dhe Këshilli i Fakultetit Veterinarisë.			
Literatura primare:	Agrarja, L., Analiza ekonomike e projekteve bujqësore, Tiranë, 1998. Doppler and H. P. Wolff (2005): Farm and Project Management and Evaluation, University of Hohenheim, Germany.			
Literatura shtesë:	Veglat analitike dhe aplikimet praktike, Washington DC: Banka Botërore. Anthony E. Boardman, David H. Greenberg., "Cost-Benefit Analysis". Upper Saddle River, New Jersey 07458.			

	Venelina Varbova, "Feasibility Study"
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1	Projekti dhe llojet e tij Karakteristikat kryesore të projektit
Java 2	Faktorët më të rëndësishëm të suksesit të projektit
Java 3	Kufizimet e projektit Shkruarja e projektit dhe prezentimi i projektit
Java 4	Anatomia e projektit
Java 5	Përshkrimi i idesë së ndërmarrësisë
Java 6	Të dhënat e tregut për projektin: nga ideja deri të komercializimi
Java 7	Përshkrimi teknik-teknologjik i Projektit
Java 8	Vlerësimi i parë
Java 9	Menaxhmenti i projektit
Java 10	Marketingu i projektit
Java 11	Të dhënat financiare të projektit
Java 12	Vlerësimi i arsyeshmerisë së projektit
Java 13	Metodat e vlerësimit
Java 14	Prezentimi i projekteve nga studentet
Java 15	Vlerësimi i dytë
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime: - Rregullat e Mirësjelljes "si: - Vijimi I rregullt I ligjeratave - Qasja ne klase ne kohë - Largimi I telefonit	

### Titulli i lëndës: SHËRBIMET KËSHILLIMORE NË BUJQËSI

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Shërbimet këshillimore në bujqësi
Niveli:	Bsc
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	3+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa ...   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Salih Saliu

Të dhënat kontaktuese:	sali.saliu@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Përmbajtja e kursit do të përfshijë tema që lidhen me mundësitë për karrierë në shërbime kshillimore bujqësore dhe do të shtjelloj çështjet kyçe me të cilat përballet edukimi bujqësor. Ky kurs do të fokusohet në zhvillimin e një plani të funksionalizimit të shërbimeve keshillimore publike dhe private.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është të ofroj njohuri studenteve rreth tranzicionit të shërbimeve keshillimore bujqësore në mbarë botën. Qeveritë ndërkombëtare po avancojnë reformat strukturore, financiare dhe menaxheriale për të përmirësuar shërbimeve keshillimore në bujqësi. Decentralizimi, pluralizmi, ndarjen e kostos, mbulimi i kostos, pjesëmarrja e palëve të interesuara në iniciativat e zhvillimit dhe vendimet dhe burimet që i prekin - këto janë disa nga elementet në tranzicion aktual të shërbimeve keshillimore bujqësore.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në përfundim të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë konceptet themelore të administrimit dhe mbikëqyrjes të shërbimeve keshillimore në bujqësi;</li> <li>- Vlerësojnë detyrat të ndryshme në funksionalizimin e shërbimeve keshillimore publike në bujqësi;</li> <li>- Vlerësojnë detyrat të ndryshme në funksionalizimin e shërbimeve keshillimore private në bujqësi;</li> <li>- Kuptojnë ndarjen e kostos, mbulimin e kostos të shërbimeve keshillimore në bujqësi.</li> </ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë
Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	2	8	16
Konsultime me mësimdhënësin	1	14	14
Puna në terren	8	2	16
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	4	8
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	8	16
Përgatitja për provimin final	1	6	6
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	4	4
Projektet, prezantimet, etj.	2	3	6

Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësim interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimi është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me goje.		
Metodat e vlerësimit:	Detyrat - 15% Pjesëmarrja ne ushtrime 2% Testi pare 35% Provimi final 48%		
Literatura primare:	Sali.Saliu-, Ligjerata te autorizuara.		
Literatura shtesë:	Extension Education; Core contents & Emerging Areas (2008) by Das Gupta. D		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjërates		
Java 1	Historia dhe Filozofia e shërbimeve këshillimore në bujqësi		
Java 2	Shërbimet këshillimore në bujqësi në Kosovë		
Java 3	Shërbimet këshillimore në bujqësi në Europe dhe Amerk		
Java 4	Funksionalizimi e shërbimeve kshillimore publike ne bujqësi		
Java 5	Funksionalizimi e shërbimeve këshillimore private në bujqësi		
Java 6	Ndarja e kostos, mbulimin e kostos të shërbimeve këshillimore në bujqësi		
Java 7	Vlersimi i parë intermediar		
Java 8	Aftësite e komunkimit dhe shërbimet këshillimor efikase		
Java 9	Metodat e Extensionit - Hulumtime dhe vlerësimet		
Java 10	Adoptimin dhe Perhapja e Inovacioneve ne bujqesi		
Java 11	Shërbimet këshillimore dhe zhvillimi rural		
Java 12	Roli i TI në modernizimin e shërbimeve këshillimore në bujqësi		
Java 13	Parimet e mësimi të të rriturve		
Java 14	Prezentimi i punimeve seminarike		
Java 15	Testi Final		
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes			
Studenti është i obligueshëm për vijimin e rregullt te ligjëratave dhe ushtrime (mbahet evidenca), duhet te mbaje qetësinë gjate mësimi, hyrja para arsimitarit – pas arsimitarit nuk lejohet hyrja ne sallën e mësimi.			

### Titulli i lëndës: SHFRYTËZIMI I KULLOSAVE

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Shfrytëzimi i kullosave
Niveli:	Bsc
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2

Kreditë ECTS:	6 ECTS		
Koha / Vendi:	Klasa ...   Sipas orarit		
Mësimdhënësi:	Ragip Kastrati		
Të dhënat kontaktuese:	ragip.kastrati@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda Shfrytëzimi i kullosave ka për qëllim që studentët të aftësoj me njohuri të përgjithshme lidhur me sipërfaqet aktuale të kullosave, përbërjen botanike të kullosave, fenofazat e zhvillimit, ndikimin e llojit dhe cilësisë së tokave, ndikimi i klimës, teknologjia e shfrytëzimit të kullosës (meliorimet, plehërimi, mënyra e kullotjes etj.</p> <p>Metodat e vlerësimit dhe kontrollit të përbërjes botanike të kullosave, mënyrat e organizimit dhe shfrytëzimit të kullosave të cilat luajn një rol shumë të rëndësishëm në prodhimtarin shtazore.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Programi ka për qëllim që studentëve të iu ofroj njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike për rëndësin e kullosave në prodhimtarinë shtazore, njohjen me metodat e vlerësimit të përbërjes botanike të kullosave dhe metodat laboratorike për vlerësimin e vlerës yshqyese të tyre .</p>		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje që të kuptojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kapacitetet dhe mundësitë e shfrytëzimit të kullosave në Kosovë</li> <li>- Të jenë në gjendje të njohin përbërjen botanike të kullosave , fenofazat e zhvillimit të kullosave, ndikimin e tokës dhe klimës në cilësinë e tyre</li> <li>- Ndikimi i shfrytëzimit të kullosave në kostën e prodhimit të produkteve blegtorale qumështit dhe mishit.</li> <li>- Të formojnë opinionin e tyre lidhur me teknologjinë e shfrytëzimit të kullosave (meliorimet, plehërimi, mënyrat e kullotjes etj.</li> <li>- Mundësit e përdorimit të menyrave më efektive të shfrytëzimit të kullosave.</li> </ul> <p>Ky model, po ashtu duhet të zhvillojë tek studentët edhe këto shkathtësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkathtësi zgjidhjes së problemeve,</li> <li>- Shkathtësi e komunikimit dhe prezantimit,</li> <li>- Shkathtësi e punës në laborator dhe teren.</li> </ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë

Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar			0
Konsultime me mësimsdhënësin	1	15	15
Puna në terren	2	4	8
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	1	12	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	4	4
Projektet, prezantimet, etj.	2	4	8
Total			150
Metodat e mësimsdhënies:	Metodologjia e mësimsdhënies është e bazuar në: Ligjërata (30%) Puna praktike (punë tereni, pune laboratorike) (30%) Pune individuale dhe prezantim nga studentet (20%) Udhëzues tjerë (10%) Vlerësimi (10%)		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 25% Vlerësimi i dytë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura primare:	R. Kastrat, "Ligjërata të autorizuara"		
Literatura shtesë:	Johnny C, Wynne. Production and Utilization of Pastures and Forages in North Carolina North Carolina Agricultural Research Service North Carolina State University Raleigh, North Carolina Technical Bulletin 305		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjërates		
Java 1	Principe të përgjithshme të rëndësisë ekonomike të kullosave në fushën e prodhimit shtazorë, sipërfaqet aktuale të kullosave si resurs i rëndësishëm ekonomik, përparësitë ekonomike të shfrytëzimit të tyre.		
Java 2	Përbërja kimike dhe vlera ushqyese e kullosave, përmbajtja e proteinave, energjisë, lëndëve minerale, vitaminave etj.		
Java 3	Përbërja botanike e kullosave dhe rëndësia e tyre ekonomike në prodhimin shtazorë, pjesëmarrja dhe njohja me llojit e bimëve graminore, leguminoze dhe bimëve të tjera.		
Java 4	Fenofazat e zhvillimit të bimës, ndryshimi i vlerës ushqyese të kullosave sipas moshës së bimës.		
Java 5	Lloji dhe cilësia e tokës, ndikimi në përbërjen kimike të kullosave dhe cilësinë e tyre.		
Java 6	Ndikimi i klimës në cilësinë e kullosave, regjimi i ujit (lagështia, temperatura, ndriçimi (insolimi) dhe era).		

Java 7	Masat agroteknike të kultivimit të kullosave, dendësia e bimëve, koha e mbjelljes etj.
Java 8	Mënyrat e shfrytëzimit të kullosave, shfrytëzimi i lirë, shfrytëzimi gjysmë i lirë, shfrytëzimi në parcela ose rrotacion,
Java 9	Mënyra e shfrytëzimit rotativ të kullosave, rendimenti , koha e regjenerimit.
Java 10	Mënyrat e krijimit të parcelave të kullosave të organizuara, lloji i përdorimit të rrethojave dhe teknikat e aplikimit.
Java 11	Aplikimi i masave rigjeneruese të kullosave pas shfrytëzimit dhe përgatitja e tyre sipas tornuseve, kositja, pastrimi, plehërimi, ujitja etj.
Java 12	Shfrytëzimi i kullosave në lopët e qumështit dhe ndikimi ekonomik në koston e prodhimit të qumështit
Java 13	Shfrytëzimi i kullosave për kategoritë e gjedhit për prodhimin e mishit dhe ndikimi ekonomik në koston e prodhimit të mishit.
Java 14	Shfrytëzimi i kullosave për lloje dhe kategori të ndryshme të ripërtpësve të imët dhe ndikimi në koston e prodhimit
Java 15	Përdorimi i kullosave për jopërtpës.
<b>Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes</b>	
Pjesëmarrja ne ligjërata dhe ushtrime është shumë e rëndësishme. Studentët inkurajohen që të jenë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Ata inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave.Profesorët dhe asistentët do të jenë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime të studentëve. Studentët do të mbështeten gjatë gjithë kohës për të përvetësuar programin.	

## **Titulli i lëndës: KURS LABORATORIK NE KIMI**

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	<b>Kurs laboratorik ne kimi</b>
Niveli:	Bsc
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të   Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa ...  Sipas orarit
Mësimdhënësi:	<b>Prof. Dr. Tahir Arbnesi</b>
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:tahir.arbneshi@uni-pr.edu">tahir.arbneshi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Kursi do të trajtojë konceptet themelore te teknikave laboratorike në kimi. Lënda do të përbëhet nga një seri leksionesh të ndërlidhura me ushtrime laboratorike. Teknikat laboratorike do të mbulojnë një game të gjerë nga fusha e metodave bazike në kimi. Komponenta e leksioneve

	do të trajtojë në detaje parimet fizike të laboratorit kimik dhe masat e sigurisë, mjetet themelore në laborator dhe mënyrat e zhvillimit të eksperimenteve Në përfundim të kursit, studenti do të ketë të zhvilluar një kuptim të qartë të teknikave laboratorike të përdorura në fushën e studimit dhe gjithashtu një përvojë në kryerjen e eksperimenteve kimike.		
Qëllimet e lëndës:	Kursi është i dizajnuar për të siguruar që të gjithë studentët, pa dallim nga edukimi i tyre paraprak, të arrijnë kompetencë dhe shkathhtësi të nevojshme laboratorike. Këto aftësi përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm në përdorimin e peshoreve analitike, enëve volumetrike, pipetave të ndryshme, kryerjen e përcaktimeve titrimetrike dhe spektrofotometrike dhe për të mësuar përdorimin dhe kalibrimin e mikroskopëve dhe centrifuga. Studentët duhet të aftësohen për përdorimin e tabelave llogaritëse dhe gjenerimin lakoreve kalibruese. Duhet theksuar edhe sistematizimi i të dhënave dhe aftësitë e interpretimi të rezultateve si dhe shkruarja e raportit laboratorik cilësorë.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e suksesshëm të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ përdorin njohuritë e teknikave laboratorike &amp; sigurisë në laborator përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve reale në laboratorin e kimisë;</li> <li>✓ shpjegojnë dhe të vlerësojnë lidhje në mes të eksperimentit dhe teorisë në kimi në përgjithësi dhe të kimisë inorganike dhe asaj organike në veçanti;</li> <li>✓ demonstrojnë shkathhtësi të kënaqshme për zgjidhjen e problemit në shumë aspekte të kimisë, duke përfshirë operacionet themelore në laborator dhe metodat e ndryshme për ndarjen e substancave nga përzierjet e tyre;</li> <li>✓ përshkruajnë bazat teorike moderne për kuptimin e fushave të rëndësishme të kimisë, duke përfshirë burimet themelore të informatave në kimi.</li> </ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej orë
Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	2	5	10
Konsultime me mësimdhënësin	1	10	10
Puna në terren	0	0	0
Testi, punimi seminarik	2	4	8

Detyrë shtëpie	2	6	12
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	6	18
Përgatitja për provimin final	2	8	16
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	2	5	10
Total			150
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, punë laboratorike, punë seminari dhe individuale.		
